



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr 03/L-040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta Zyrtare nr 28/2008 dhe nenit 51 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr 01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë, bien këtë:

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NË SHUMË PREJ 2.500,00€
AKV 'KEMAJL AZIZI'

I.

Me këtë Vendim, Kryetari i Komunës së Vitisë **NDANË** mjete financiare në shumë prej 2.500,00€ me shkronja (dymijë e pesqind euro) AKV "Kemajl Azizi", në emër të përmbushjes së obligimeve sipas Vendimit për zyrtarizmin e ansamblit të këngëve dhe valleve "Kemajl Azizi" si ansambël zyrtar i Komunës së Vitisë nr 01-013/2346 të datës 13.12.2011.

II

Mjetet nga neni 1 i këtij Vendimi, sigurohen nga Buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2016 nga kodi buxhetor subvencione i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport. Obligohet Drejtori i AKV "Kemajl Azizi" nga Vitia që të paraqet raport me shkrim për mjetet e shpenzuara nga neni 1 i këtij vendimi te Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Vitisë.

III

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdeset Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Zyra e Thesarit e Komunës së Vitisë

IV

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kryetarit të Komunës së Vitisë.

Drejtoresha e DKRS-se
Kaltrina G. SYLEJMANI

Viti, 07.06.2015

Vendimi u dorëzohet:

1. AKV "Kemajl Azizi"
2. Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
3. Zyrës së thesarit dhe
4. Arkivit

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË
Sokol HALITI

